



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 44
Prishtinë, më 28 prill 2010
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225
Mbledhja filloi në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë anëtarët e Komisionit: Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj, Suzana Novoberdaliu, Eqrem Kryeziu dhe Radmila Vujoviq.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nuredin Ibishi, Afrim Hoti dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më **31. 03. 2010**,
3. Shqyrtimi i agjendës për vizitën në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Policinë e Kosovës,
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 31. 03. 2010

Procesverbali i 31. 03. 2010 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i agjendës për vizitën në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Policinë e Kosovës

Kryetari i Komisionit – Pas riformatizimit të Qeverisë është ndërruar Ministri i MPB - së dhe drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Unë kam menduar me stafin ta bëjmë një agjendë dhe ne, si deputetë, të marrim vendim për t'i vizituar këto dy institucione. Kjo është pjesë e takimeve që Komisioni duhet të ketë si organ mbikëqyrës i këtyre institucioneve.

Shkumbin Demaliaj – Mendoj se është ide e mirë dhe ne duhet t'i zhvillojmë këto takime dhe të shohim se çka kanë planifikuar Ministri i MPB - së dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Unë jam për ndërtimin e agjendës dhe vizitës në këto institucione.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozimin e kryetarit të Komisionit.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – Unë i kam dy çështje për t'i diskutuar. Çështja e parë është sjellja e Policisë në kohët e fundit, si dhe mënyra e paraqitjes së tyre. Unë bëj thirrje te Ministria dhe te Policia e Kosovës, që në mënyrë operacionale të operojnë konform parimit të përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit në detyrë. Gjithsesi duhet të shikohet Ligji për Policinë e Kosovës. Policia e Kosovës duhet të funksionojë në mënyrë më profesionale.

Çështja tjetër është funksionimi jo i duhur i EULEX - it. Anëtarët e Komisionit duhet të jenë të fokusuar në këto ngjarje që po ndodhin.

Pasi që nuk kishte pika të tjera për diskutim, kryetari i Komisionit e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Rrustem Mustafa

